

TREGIMI I PEJGAMBERIT

EJJUB



Özkan Öze
Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT

EJJUB



Në pamjet që ilustrojnë libërthat e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/5
Libra për fëmijë: 349/5

Drejtuesi i botimeve:

Dr. Fatih Kurt

Koordinatori i botimeve:

Lokman Arslan

Analizimi i veprës:

Hale Şahin

Elif Erdem

Editor

Zeynep Ulviye Özkan

Përktheu

Florida Kulla

Redaktor gjuhësor

Fatjon Çuka

Ndjekja e botimit

Uğur Altuntop

Botimi

Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© **Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë**

Kontakt

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr





Në tokat e Sirisë së sotme, para shumë kohësh,
kishte një qytet të bukur.

Kishte tokë të begatë, ajër të pastër dhe ujë të
shijshëm.

Ejjubi ishte burri më i pasur i këtij qyteti të bukur.



Kishte tufa delesh që mbushnin luginat,
vreshta dhe kopshte, prodhimet e të cilave nuk
kishin të mbaruar;
kishte fëmijë të shëndetshëm, çdonjëri më i bukur se
tjetri.
Dhe një bashkëshorte zemërmirë, një fole të lumtur...
Ejjubi ishte një person bujar, pikërisht ashtu si i ati,
Pejgamberi Ibrahim.
Dhe Allahu e zgjodhi atë si pejgamber.





Ai ushqente të uriturit, vishte të zhveshurit,
kujdesej për nevojtarët
Dhe ai ishte një rob shumë falënderues.
Falënderonte natë e ditë Allahun për gjithë këtë
pasuri që zotëronte.
Sa më shumë falënderonte, aq më shumë i jepte
Allahu,
sa më shumë i jepte Allahu, aq më shumë
falënderonte Pejgamberi Ejjub.



Fakti që Pejgamberi Ejjub ishte një rob shumë i mirë,
bëri që të shqetësoheshin disa të tjerë.

Thoshin: "More, edhe ne po të ishim kaq të pasur do
ta falënderonim Allahun mëngjes e mbrëmje. Dhe do
të ndihmonim të varfrit"

Vallë vërtet kështu ishte?





Nëse Pejgamberi Ejjub do të ishte një person i varfër,
a nuk do ta falënderonte zotin e tij?
Allahu dëshiroi t'u tregojë melekëve dhe njerëzve se
ç'rob ishte ai.

Te kafshët që mbushnin luginat u shfaq një sëmundje e papritur.

Ngordhën të gjithë qengjat, lopët, kuajt dhe devetë..

Por Ejjubi ishte një rob durimtar.


Ai tha: "Allahu i dha, Allahu i mori."

Më pas u vyshkën arat e pafundme, vreshtat dhe pemishtet,

por Pejgamberi Ejjub u bë një rob durimtar.

Familja e tij ra në varfëri.

Një ditë u shemb edhe shtëpia e tyre.





Pejgamberit Ejjub i vdiqën të gjithë fëmijët
Ejjubi qau. Madje shumë,
por vazhdoi të ishte një rob durimtar.
Tha: "Allahu i dha, Allahu i mori" ...
Pas një kohe Allahu sëmuri edhe Pejgamberin Ejjub.
Sëmundja ishte shumë e rëndë.


Pranë Pejgamberit Ejjub nuk mbeti askush tjetër,
veç së shoqes.

Të gjithë e braktisën.

Vitet kaluan kështu me dhimbje dhe vështirësi.

Ai ishte pikërisht një hero durimi.

Kurrë nuk ankohej.





Shejtani zemërohej shumë me këtë gjendje të tij.
Duhet të bënte diçka dhe të mundësonte që
Ejjubi të hiqte dorë nga përmendja e Allahut
dhe nga falënderimi i Tij.
Por kurrë nuk arriti ta mashtronte atë.

Kështu u mundua të mashtronte të shoqen e tij.


I doli përballë maskuar me petkun e një burri.

I tha: "Më shih, moj vajzë!

"Thuaji tët shoqi të heqë dorë nga përmendja e Allahut

Sepse sa më shumë të thotë ai 'Allah!', aq më shumë do të shtohen vështirësitë.






Nëse do të heqë dorë nga përgjërimi ndaj
Allahut, edhe Allahu e braktis atë.

Sëmundja do t'i kalojë.”

Në të vërtetë e shoqja e Ejjubit nuk i besoi
atij, por ia tha këto fjalë Ejjubit



Pejgamber Ejjubi u zemërua shumë.

Për herë të parë zemërohej kaq shumë me të
shoqen.

Tha: "Këto janë fjalët e shejtanit!"

I tha se tashmë dëshironte të qëndronte vetëm...

E shoqja e la vetëm dhe iku...

Ditët rridhnin një nga një.




Ejjubi kurrë nuk hiqte dorë nga përmendja e Allahut, duke ruajtur durimin dhe vetëm nga Allahu kërkonte ndihmë. Një ditë Allahu e urdhëroi Pejgamberin Ejjub dhe i tha: "Godite tokën me këmbë!" Pejgamberi Ejjub e goditi tokën me këmbë.



Nga toka doli ujë i pastër, i freskët dhe
shërimdhënës.

Ejjubi piu nga ky ujë dhe u la.





Të gjitha sëmundjet që kishte iu zhdukën brenda pak çastesh.

Të gjitha plagët iu shëruan.

Kjo ishte një mrekulli e Allahut

Allahu i kishte dhënë shërim Pejgamberit Ejjub.



E shoqja e Pejgamberit Ejjub u bë kureshtare për të shoqin dhe u kthye pranë tij,
por nuk e gjeti në krevat
Kur pa sa majtas-djathtas, vuri re se ai ish bërë më i shëndetshëm se ç'kishte qenë më parë.
Kjo ishte një mrekulli e madhe.





Pejgamberi Ejjub, bashkë me shëndetin gjeti
edhe ditët e hershme të pasurisë.
Allahu i kishte dhënë përsëri atij një pasuri të
bollshme.
Kuj, lopë me qumësht të bollshëm dhe deve..
Ara të gjera dhe të gjata,
pemishte të mbushura me pemë frutore..
Allahu i dha atij edhe një jetë të gjatë.

Ejjubi u bë sërish me fëmijë të shëndetshëm, të mirë dhe të pastër.

Jetoi në mes të njerëzve si një peygamber i madh që i dëgjohej fjala.

“Sa rob i mirë ishte ai! Gjithnjë drejtohej drejt Allahut.”





Ja, pra, kjo është historia e Pejgamberit
Ejjub, heroit të durimit
Sa histori e bukur është kjo, histori nga e
cila nxirret mësim...

